

RREGULLORE NR. 1999/24

UNMIK/RREG/1999/24

12 dhjetor 1999

PËR LIGJIN NË FUQI NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të përcaktimit të ligjit në fuqi në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

LIGJI NË FUQI

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

- (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe
- (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në:

- (a) Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të 10 dhjetorit 1948;
- (b) Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj;

- (c) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj;
- (d) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetorit 1966;
- (e) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965;
- (f) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave të 17 dhjetorit 1965;
- (g) Konventën kundër torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës apo degradues ose ndëshkues të 17 dhjetorit 1984;
- (h) Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të 20 dhjetorit 1989.

1.4 Asnjë person, i cili ushtron detyra publike apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë nuk lejohet të diskriminojë ndonjë person tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër. Në procedurat penale, i pandehuri përfiton nga dispozita më e favorshme e ligjit penal në fuqi që nga data 22 mars 1989 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje.

1.5 Dënimi me vdekje hiqet.

Neni 2 **ZBATIMI**

Gjykatat në Kosovë mund të kërkojnë sqarime nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm u jep gjykatave sqarime të nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre.

Neni 3 **HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 qershor 1999.

Neni 4 **DISPOZITA KALIMTARE**

Të gjitha aktet ligjore, duke përfshirë edhe vendimet gjyqësore, dhe efektet ligjore të veprimeve që kanë ndodhur nga 10 qershori 1999 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje, në përputhje me legjislacionin në fuqi gjatë asaj periudhe sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, datë 25 korrik 1999, do të mbeten në fuqi derisa nuk bien në kundërshtim me standardet e referuara në nenin 1 të kësaj rregulloreje apo të çdo rregulloreje tjetër të UNMIK-ut në fuqi gjatë kohës kur kanë ndodhur veprat e tilla.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm
